

32.810

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE
Nr. 32810

V E N D I M

PER RREGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Ne Tirane, sot me **25.01.2005**, une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, **Ariana CACO**, pasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentet e paraqitura nga kerkuesi **Zoti Genci LIKOSKENDAJ**, i biri i Laverit dhe Farfurise, lindur ne Fier, me 16.02.1969, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel - Tirane, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1765664, **Administrator i Shoqerise ne krijim e siper "C.C.S. OFFICE " Sh.P.K.**,

per rregjistrimin si person juridik te Shoqerise "**C.C.S. OFFICE**" SHPK dhe pasi,

KONSTATOVA SE

Me date 11.01.2005 zoti **Genci LIKOSKENDAJ** ka themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "**C.C.S. OFFICE**" **Sh.P.K.**, gje qe provohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqerise si dhe Vertetimi i Bankes Kombetare Tregtare - Tirana 1, i cili verteton se prane asaj Banke eshte depozituar shuma 300.000 (treqindmije) leke si kapital themeltar per krijimin e Shoqerise "**C.C.S. OFFICE**" **Sh.P.K.**

Kerkesa e paraqitur nga kerkuesi **Genci LIKOSKENDAJ**, per rregjistrimin si person juridik te Shoqerise "**C.C.S. OFFICE**", **Sh.P.K.**, e cila ka:
Ortak te Vetem zotin Genci Likoskendaj,
Objekt te veprimtarise: **Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrove dhe te kancelerise. Sherbime ne fushen e Informatikes, Elektronikes dhe Internetit. Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme.**

Kapitalin themeltar te Shoqerise 300.000 (treqindmije) leke.
Administrator te Shoqerise zotin Genci LIKOSKENDAJ.
Selin e Shoqerise ne Rrugen “ Sulejman DELVINA “, prane Disko “ San PAOLO ” - Tirane.
Kohezgjatjen e Shoqerise 99 (nentedhjeteenente vjet).

eshte e drejte dhe ne baze te Ligjit duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 “ **Per Shoqerite Tregtare** ” dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 “ **Per Rregjistrin Tregtar ...** ”

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “ **C.C.S. OFFICE** ” SH.P.K., e cila ka:

Ortak te Vetem zotin Genci Likoskendaj.

Objekt te veprimtarise: Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancelerise. Sherbime ne fushen e Informatikes, Elektronikes dhe Internetit. Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme.

Kapitalin themeltar te Shoqerise 300.000 (treqindmije) leke.

Administrator te Shoqerise zotin Genci LIKOSKENDAJ.

Selin e Shoqerise ne Rrugen “ Sulejman DELVINA “, prane Disko “ San PAOLO ” - Tirane.

Kohezgjatjen e Shoqerise 99 (nentedhjeteenente vjet).

Kunder Vendimit mund te behet ankim.

GJYQTARE

Ariana CACO





A K T

THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ C.C.S. OFFICE ” SH.P.K.

Personi qe firmos me poshte:

Zoti Genci LIKOSKENDAJ, i biri i Laverit dhe Farfurise, lindur ne Fier, me 16.02.1969, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel - Tirane, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1765664.

ka hartuar, si me poshte vijon, Aktin e Themelimit te nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht, por jo ekskluzivisht, me **Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 “ Per Shoqerite Tregtare ”**, aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se Shoqerise, si dhe me dispozitat e Statutit te Shoqerise qe i bashkelidhet ketij Akti Themelues.

Emertimi i Shoqerise eshte “ C.C.S. OFFICE ” SH.P.K.

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rruga “ Sulejman DELVINA ”, prane Disko “ San PAOLO ” - Tirane.

HOTERIE
TIRANE

Kohezgjatja e Shoqerise eshte 99 (nentedhjeteeente) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

OBJEKTI i veprimtarise se Shoqerise eshte :

Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancerise.

Sherbime ne fushen e Informatikes, Elektronikes dhe Internetit.

Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 300.000 (treqindmije) leke.

Ky kapital perbehet nga kontributi i meposhtem ne para i Ortakut te Vetem:

Zoti Genci LIKOSKENDAJ, kontribuon me shumen 300.000 (treqindmije) leke.

Kapitali Themeltar eshte i ndare ne 300 (treqind) pjese, plotesisht te shlyera, me vlere 1000 (njemije) leke secila, te renditura sipas numrit te serise nga 1 (Nje) ne 300 (treqind).

Ne baze te kontributit te lartpermendur :

Zoti Genci LIKOSKENDAJ merr 300 (treqind) pjese te Kapitalit Themeltar, te renditura nga numri i series 1 (Nje) deri ne numrin e serise 300 (treqind).

Te gjitha pjeset e Kapitalit Themeltar jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht.

Ortaku i Vetem ka derdhur shumen koresponduese te pjeseve te nenshkuara.
Shuma e mbledhur prej tij eshte depozituar ne Banken Kombetare Tregtare te Shqiperise – Tirana 1, ne nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim e siper.

Shuma e depozituar vertetohet me ane te nje çertifikate te leshuar nga ajo Banke.

Personi qe firmos kete Akt pasi ka marre dijeni per kete çertifikate, deklaroi se shuma e derdhur prej tij eshte ne perputhje me ate qe shenohet ne çertifikate dhe se ai konfirmon nenshkrimin e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumen respektive te derdhur.

Shoqeria do te administrohet nga nje ose disa administratore te cileve u jane besuar te gjitha plotfuqite per administrimin e saj, perjashtuar ato qe ligji dhe Statuti bashkengjitur ja rezervojne Ortakut te Vetem.



Administratori ose administratoret do te jene te emeruar per tre vjet duke filluar nga emerimi i tyre dhe mund te shkarkohen nga Ortaku i Vetem.

Nepermjet ketij Akti emerohet si Administrator i Shoqerise **Zoti Genci LIKOSKENDAJ**, i biri i Laverit dhe Farfurise, lindur ne Fier, me 16.02.1969, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel - Tirane, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1765664, te cilit i jepen te gjitha kompetencat, qe ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet per krijimin e Shoqerise, parashikuar sipas ligjit ne fuqi.

Ai eshte i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise qe krijohet deri ne regjistrimin e saj ne gjykate, vecanerisht ai eshte i pajisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer te Shoqerise, te cilat i kalojne Shoqerise nga momenti i regjistrimit.

Pervec te tjerave, Administratori eshte i ngarkuar per te kryer akte dhe angazhime qe jane ne perputhje me objektin e Shoqerise dhe kompetencat e tij.

Pasi te behet regjistrimi i Shoqerise, keto akte dhe angazhime i nenshtrohen miratimit te Ortakut te Vetem, jo me vone se sa nga data e vendimit te tij te pare, qe shqyrton dhe vendos mbi llogarite e vitit te pare financiar.

Ky miratim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te Shoqerise.


Viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane dhe mbaron me 31 dhjetor 2005.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne Tirane, me 11.01.2005, ne pese ekzemplare origjinale, duke pasur te gjitha ekzemplaret fuqi te barabarte ligjore.

FIRMOSUR NGA :

ORTAKU I VETEM

Genci LIKOSKENDAJ





STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ C.C.S. OFFICE ” SH.P.K.

Personi qe firmos me poshte:

Zoti Genci LIKOSKENDAJ, i biri i Laverit dhe Farfurise, lindur ne Fier, me 16.02.1969, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel - Tirane, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1765664.

ka hartuar, si me poshte vijon, Statutin e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

KREU I

FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 1

Forma

Krijohet nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, e cila e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht, por jo ekskluzivisht, **Ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"**, aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se Shoqerise, si dhe me dispozitat e ketij Statuti.

Neni 2



Emertimi

Emertimi i Shoqerise eshte “ C.C.S. OFFICE ” SH.P.K.

Neni 3 Objekti i veprimtarise

OBJEKTI i veprimtarise se Shoqerise eshte :

Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancelerise.

Sherbime ne fushen e Informatikes, Elektronikes dhe Internetit.

Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme.

Neni 4 Selia

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rruga “ Sulejman DELVINA “, prane Disko “ San PAOLO ” - Tirane.

Transferimi i selise se Shoqerise behet me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 5 Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise 99 (nentedhjeteenente) vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet kur Shoqeria priset para kohe.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR, LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE

Neni 6 Kapitali Themeltar





Kapitali Themeltar eshte 300.000 (treqindmije) leke.

Ai eshte i ndare ne 300 (treqind) pjese, plotesisht te shlyera, me vlere 1000 (njemije) leke secila, te renditura sipas numrit te serise nga 1 (nje) ne 300 (treqind).

Fondet qe rrjedhin nga shlyerja e pjeseve depozitohen ne **Banken** , per llogari te Shoqerise qe krijohet.

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit themeltar behet me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 7

Kontributi i Ortakut te Vetem

Kapitali Themeltar perbehet nga kontributi i meposhtem ne para i Ortakut te Vetem :

Zoti Genc LIKOSKENDAJ, kontribuon me shumen 300.000 (treqindmije) leke.

Neni 8

Pjeset e Kapitalit Themeltar

Ne baze te kontributit te lartpermendur :

Zoti Genc LIKOSKENDAJ merr 300 (treqind) pjese te Kapitalit Themeltar, te renditura nga numri i series 1 (nje) deri ne numrin e serise 300 (treqind).

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar, nenshkruhen, shlyhen plotesisht dhe i takojne Ortakut te Vetem sipas ndarjes se mesiperme.

Neni 9

Lenia dhe transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'ju transferohen te treteve vetem me vendin te Ortakut te Vetem.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 10
Ortaku i Vetem dhe vendimet e tij

Ortaku i Vetem i Shoqerise perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

Ortaku i Vetem ka te drejten e vendimmarrjes per te gjitha problemet qe kane te bejne me administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te Shoqerise.

Ne ushtrimin e te drejtes se tij per te marre vendime, Ortaku i Vetem ka te drejte te perfaqesohet nga nje person i zgjedhur prej tij.

Ortaku i Vetem me vendimet e tij per administrimin e zakonshem te Shoqerise vendos per çeshtje te tilla si emerimi ose shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, percakton shperblimin e administratoreve dhe te ekspertit kontabel te autorizuar, vendos per problemet e tjera te drejtimit te Shoqerise te paraqitura nga administratoret, etj.

Ortaku i Vetem me vendimet e tij per administrimin e jashtezakonshem te Shoqerise vendos per çeshtje te tilla si ndryshimet e statutit, mbi kopetencat e likuidatoreve, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, shnderrimi i Shoqerise ne shoqeri te formave te tjera etj.

Neni 11
Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje ose disa administratore, qe duhet te jene persona fizike dhe mund te jene ose jo ortake ne Shoqeri.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me miratimin e Ortakut te Vetem.



Emerimi i tyre behet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh nga emerimi i tyre me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem.

Ne maredhenie me Ortakun e Vetem dhe te tretet administratoret kane te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te Shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e Shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe statuti ja japin shprehimisht Ortakut te Vetem.

Administratoret jane pergjegjes ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Neni 12

Ekspertet kontabel te autorizuar

Ne rast nevojje ose nese e kerkon ligji, kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite duke filluar nga data e emerimit te tyre me mundesi rizgjedhje nga Ortaku i Vetem.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 13

Viti financiar, llogarite vjetore

Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, relacionet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetem.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behen brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.





Neni 14 Dividentet

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Ortaku i Vetem percakton pjesen qe i takon atij ne formen e dividendit mbi fitimin.

Fitimi, qe do t'i ndahet Ortakut te Vetem, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te çdo viti, deri sa ky fond te arrije vleren 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

KREU V ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 15 Prishja

Shoqeria priset me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 5 te ketij Statuti, me perjashtim te rasteve ku behet zgjatja e afatit sipas nenit 5 ose kur ka nje prishje te parakohshme per aresyet e parashikuara me ligj.

Neni 16 Likuidimi

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj.

Per kryerjen e ketij procesi Ortaku i Vetem emeron nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit Ortaku i Vetem vendos, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura Ortakut te Vetem.

TIRANE

KREU VI DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 17 Shnderrimi i Shoqerise

Shnderrimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive, ne shoqeri komandite dhe shoqeri anonime mund te kryhet vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 18 Mosmarreveshjet

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do ti paraqiten per zgjidhje gjykatave kompetente shqiptare.


Dispozita Perfundimtare Neni 19

Ky Statut eshte hartuar ne Tirane, me 11.01.2005, ne pese ekzemplare origjinale, duke patur te gjitha ekzemplet fuqi te barabarte ligjore.

FIRMOSUR NGA:

Ortaku i Vetem

Genc LIKOSKENDAJ





32310

9 A Coco
25 JANAR 2005**K E R K E S E**

Kerkues: Zoti Genci LIKOSKENDAJ, i biri i Laverit dhe Farfurise, lindur ne Fier, me 16.02.1969, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel - Tirane, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1765664 Administrator i Shoqerise ne krijim e siper "C.C.S. OFFICE" Sh.P.K.

OBJEKTI: Regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ne krijim e siper "C.C.S. OFFICE" Sh. P. K.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.7638, date 10.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin tregtar ...".

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**TIRANE**

Ne perputhje me normat perkatese te Legjislacionit shqiptar, zoti Genci LIKOSKENDAJ ka krijuar Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "C.C.S. OFFICE" Sh.P.K.

Objekti i veprimtarise se saj eshte: Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme; Sherbime ne fushen e Informatikes dhe Elektronikes; Importimi dhe Eksportimi i pajisjeve te zyrave dhe te kancelerise.

Shoqeria ka depozituar prane Bankes Kombetare Tregtare Nr 1 kapitalin themeltar te saj, i cili eshte 300.000 leke.

Ne dokumentat e Shoqerise eshte percaktuar forma e saj, qe eshte SH.P.K.

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rruga "Sulejman DELVINA", prane Disko "San PAOLO" - Tirane.

Kohezgjatja e Shoqerise eshte nentredhjetenete vjet.

Administrator i Shoqerise eshte Genci LIKOSKENDAJ.

Bashkelidhur ju paraqesim dokumentet e nevojshme.

K E R K U E S
Administratori
Genci LIKOSKENDAJ

Tirane, me 12.01.2005



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR ~~77~~ REP.
NR — Kol

VERTETIM

Sot ne daten 18.01..2005 (dymije e pese) para meje noteres Adelina Nini me zyre ne rrugen "M Gjollesha " u paraqit personalisht Zoti Genci Likskendaj i datlindjes 16.02.1969, me banim ne Tirane blloku i vilave , me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pashaporten Nr 1765664, i cili deklaroi se sa me siper e ka nenshkuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noterja pasi e gjeta ate konform ligjes, e vertetoj.

NOTERE



DEGA TIRANA 1

Bulevardi 'Zhan d'Ark'

Tel:++355(0)4 266276/7/8


Fax:++355(0)4 266282

Tirane, me 21-01-2005

VERTETIM

Me te cilen vertetojme se **Z.GENC LIKSKENDAJ** ka depozituar prane deges se BKT-se Tirana 1, shumen **300.000 (Treqind mije) Leke** si kapital fillestar per krijimin e shoqerise "**CCS OFFICE**" **SHPK**

E leshojme kete vertetim me kerkesen e vete klientit



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 79 REP.
NR 3/ Kol


VERTETIM

Sot ne daten 18.01..2005 (dymije e pese) para meje noteres Adelina Nini me zyre ne rrugen "M Gjollësha " u paraqit personalisht Zoti Genci Likskendaj i datlindjes 16.02.1969, me banim ne Tirane blloku i vilave , me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pashaporten Nr 1765664, i cili deklaroi se sa me siper e ka nenshkruar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noterja pasi e gjeta ate konform ligjes, e vertetoj.

NOTERE



Adelina Nini




REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 78 REP.
NR 31 Kol

VERTETIM

TIRANE

Sot ne daten 18.01.2005 (dymije e pese) para meje noteres Adelina Nini me zyre ne rrugen "M Gjollës" u paraqit personalisht Zoti Genci Likskendaj i datlindjes 16.02.1969, me banim ne Tirane blloku i vilave , me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pashaporten Nr 1765664, i cili deklaroi se sa me siper e ka nenshkruar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noterja pasi e gjeta ate konform ligjes, e vertetoj.

NOTERE



Adelina Nini

